



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 12.03.2014

Nr.0204-307

PËR: **Rasim Selmanaj**, Kryetar i Komunës së Deçanit
Jashar Dobraj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Deçanit

LËNDA: KONFIRMIMI I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DEÇANIT 01.Nr.II-2 të pranuar më datën 11.03.2014

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në nenin 81.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Rregulloren Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive shtojca XII, pas shqyrtimit të vendimit 01.Nr.II-2 të miratuar me datën 28.02.2014 nga Kuvendi i Komunës së Deçanit, **KONFIRMON** ligjshmërinë e aktit, dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cilin prodhon efekt të plotë juridik është si vijon:

- **Vendim për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta dhe publike të kuvendit komunal të Deçanit dhe mbledhjeve të Komitetit për Politik dhe financa për vitin 2014**

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së

Kopje: *Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL*
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 12.03.2014
Br.0204-307

Za: Rasim Selmanaj, Gradonačelnik Opštine Dečane
Jashar Dobraj, Predsedavajući Skupštine Opštine Dečane

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE SKUPŠTINE OPŠTINE DEČANE
01.Br.II-2 primljeno dana 11.03.2014

Poštovani,

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave, u skladu sa njenim mandatom definisano Zakonom Br.03/L-040 o Lokalnoj Samoupravi, kao i Uredbe Br.02/2011, o Odgovornim Administrativnim Oblastima Kancelarije Premijera i Ministarstva dodatak XII, nakon razmatranja Odluke 01.Br.II-2 odobreno dana 28.02.2014 od strane Skupštine Opštine Dečane, Potvrđuje zakonitost akta i procenjuje da isti taj je u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi.

Pravni akt sa potpunim pranim dejstvom je kao što sledi:

- **Odluka o odredjivanju rasporeda održavanja redovnih sastanaka i javnih Skupštine Opštine Dečane i sednica Odbora za Politiku i Finansije za 2014 godinu**

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a

Kopija: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocim odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a



Në bazë të nenit 38.4 të Statutit Komunal, Kuvendi Komunal i Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.28.02.2014, nxjerrë këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E ORARIT TË MBAJTJES SË MBLEDHJEVE TË RREGULLTA DHE PUBLIKE TË KUVENDIT KOMUNAL TË DEÇANIT DHE MBLEDHJEVE TË KPF-së PËR VITIN 2014

Neni 1.

Caktohet orari i mbajtjes së mbledhjeve të rregullta dhe mbledhjeve publike të Kuvendit të Komunës së Deçanit, si dhe mbledhjeve të KPF-së për vitin 2014.

Neni 2.

Kuvendi i Komunës së Deçanit do t'i mbajë mbledhjet e rregullta të premten e fundit të çdo muaji.

Nëse data e caktuar sipas këtij orari përkon me ndonjë ditë feste ose datë tjetër që nuk punohet, mbledhja mund të mbahet një ditë pune para ose pas orarit të caktuar.

Neni 3.

Kuvendi i Komunës së Deçanit do të mbajë së paku 2(dy) mbledhje publike, me 19 Qershor dhe 17 Dhjetor.

Neni 4.

Komiteti për Politikë dhe Financa do të mbajë mbledhjet e veta të rregullta 3 ditë para mbledhjeve të Asambles.

Neni 5.

Kuvendi i Komunës dhe Komiteti për Politikë dhe Financa mund të mbajnë edhe mbledhje tjera të rregullta jashtë këtij orari sipas nevojave dhe kërkesave të paraqitura.

Neni 6.

Për mbajtjen e mbledhjeve në datat e caktuara anëtarët e Kuvendit dhe KPF-së do të njoftohen së paku 7 ditë pune para datës së mbajtjes së mbledhjes, ndërsa mbledhjet publike do të publikohen së paku 2 javë para takimit.

Neni 7.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryesuesi i Kuvendit Komunal dhe Zyra për Punë të Kuvendit dhe Ekzekutivit.

Neni 8.

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës.

01.Nr.II-2

Deçan, dt.28.02.2014 KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi: Jashar Dobraj

KK-Deçan	5527
01	04-03-14

